

# **Statuti themeltar i Mbretërisë Shqiptare**

Kombi shqiptar, i lirë e kryelartë, me plot shpresa lumturie për kohën e ardhme, me dëshirë të patundshme e plot gjallëri për forcimin e përhjetshëm të bashkimit kombëtar dhe për sigurimin e zhvillimit paqësor të Atdheut e të mirës së përgjithshme të popullit, duke respektuar traditat historike të kombit, të cilat pa dyshim i sigurojnë brezit të ardhshëm një mbarëvajtje të meritueshme, në Kuvendin e dytë kushtetues, më datë 1 dhjetor 1928, vendos dhe dekreton këtë Statut.

## **Titulli I**

### **Dispozita të përgjithshme**

Art. 1. Shqipëria është Mbretëri (Royaume) demokratike, parlamentare dhe e trashëgueshme.

Art. 2. Shqipëria është e pavarur dhe e pandashme; tërësia tokësore e saj është e padhunueshme dhe toka e saj e patjetërsueshme.

Art. 3. Flamuri shqiptar është i kuq, në mes me shqipe të zezë dykrerëshe.

Art. 4. Gjuha zyrtare e Shtetit është shqipja.

Art. 5. Shteti shqiptar nuk ka fe zyrtare. Të gjitha fetë e besimet janë të nderuara dhe liria e ushtrimit dhe e praktikimit të jashtëm të tyre është e siguruar.

Feja nuk mund të formojë pengesa juridike në asnjë mënyrë.

Fetë dhe besimet kurrsesi nuk mund të përdoren për qëllime politike.

Art. 6. Kryeqyteti i Shqipërisë është Tirana.

## **Titulli II**

### **Pushtetet Shtetërore**

Art. 7. Të gjitha pushtetet shtetërore burojnë nga Kombi, dhe ushtrohen sipas parimeve e rregullave që caktohen në këtë Statut.

Art. 8. Pushteti Legjislativ ushtrohet kolektivisht prej Mbretit dhe Parlamentit i cili përbëhet prej një Dhome.

Art. 9. Iniciativa e ligjeve i përket Mbretit dhe Parlamentit. Por propozimi i ligjeve që sjellin shtesa shpenzimesh financiare, i përket Mbretit.

Art. 10. Interpretimi i saktë i ligjeve i përket Pushtetit Legjislativ.

Art. 11. Çdo ligj për të qenë i zbatueshëm duhet të jetë i votuar prej Parlamentit dhe i miratuar (sanctionner) prej Mbretit.

Art. 12. Asnjë ligj nuk mund t'i paraqitet Mbretit për miratim (sanction), para se të jetë i votuar rregullisht prej Parlamentit. Ligjet nuk mund të shfuqizohen (abroger), të ndryshohen (modifier), të pezullohen (suspendre), veçse me një ligj tjetër.

Art. 13. Pushteti Përmbarues i përket Mbretit, i cili e ushtron sipas dispozitave të caktuara në këtë Statut.

Art. 14. Pushteti Gjyqësor ushtrohet prej gjykatave dhe vendimet e tyre, të bazuara në ligj, jepen dhe zbatohen në emër të Mbretit.

## **Kapitulli I**

### **Pushteti Legjislativ**

Art. 15. Parlamenti përbëhet prej deputetësh të zgjedhur nga populli sipas ligjit.

Art. 16. Për çdo 15. 000 (pesëmbëdhjetë mijë) njerëz, dhe për çdo grupim që kalon 7.500 (shtatë mijë e pesëqind) njerëz zgjidhet një Deputet.

Art. 17. Parlamenti zgjidhet për një periudhë katërvjeçare.

Art. 18. Deputeti përfaqëson Kombin përgjithësisht dhe jo vetëm krahinën që e ka zgjedhur.

Art. 19. Cilësitë e zgjedhësve caktohen me ligjin e zgjedhjeve.

Art. 20. Për t'u zgjedhur deputet, duhet të ketë këto cilësi:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë mbushur moshën 30 vjeç.
- c) Të gëzojë të drejtat civile e politike;
- d) Të mos ketë kufizimet që caktohen në ligjin e zgjedhjeve.

Art. 21. Cilësia e deputetit është e papajtueshme me çdo nëpunësi të Shtetit me rrogë, përveç Ministrisë; gjithashtu cilësia e deputetit është e papajtueshme me nëpunësi komunale ose me shërbim aktiv fetar.

Deputeti nuk mund të marrë pjesë në mbledhjet e Parlamentit me rroba fetare.

Deputeti nuk mund të marrë në pajtim pasuri të paluajshme të Shtetit dhe të marrë përsipër provizione ushtarake ose punë botore. Gjithashtu, deputeti nuk mund të marrë në pajtim taksa Shteti.

Art. 22. Deputetit nuk mund t'i jepet asnjë porosi urdhërore prej zgjedhësve të vet.

Art. 23. Deputetët kanë të drejtë të marrin një shpërblim prej Fr. ari 8400 (tetëmijë e katërqind) në vit; kjo shumë mund të ndryshohet herë pas here me ligj.

Art. 24. Deputetëve nuk mund t'u kërkohet përgjegjësi për mendimet e shfaqura dhe për votat e dhëna në Parlament.

Art. 25. Në kohën e sesionit, deputetët nuk mund të gjenden të burgosur për borxh; edhe në qofshin, me hapjen e sesionit, lirohen menjëherë.

Art. 26. Deputetët, për sa kohë vazhdon periudha parlamentare, nuk mund të ndiqen ose të arrestohen për çështje penale (komunale ose politike) pa lejen e Parlamentit, veçse kur kapen në ngjarje të dukshme; në këtë rast, autoritetet gjyqësore janë të detyruara të lajmërojnë Parlamentin brenda 24 orëve nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë.

Art. 27. Vendimet penale që jepen kundër një deputeti, nuk zbatohen derisa vazhdon sesioni parlamentar; kjo kohë nuk llogaritet në parashkrim.

Art. 28. Përveç rasteve të jashtëzakonshme të caktuara në këtë Statut, Parlamenti mbledhet vetiu çdo vit në një sesion pesëmuajsh të rregullt, i cili fillon më 15 Tetor dhe mbaron më 15 Mars, por nuk mund të mbyllet pa votuar buxhetin e Shtetit.

Sesionet mbyllen me dekret mbretëror.

Art. 29. Parlamenti shqyrton kompetencat e cilësitë ligjore të deputetëve dhe gjykon e vendos mbi të sipas dispozitave të rregullores së brendshme.

Vendimet mbi anulimin e një zgjedhjeje për shkak ilegaliteti, ose mospranimi i një deputeti për shkak të mungesës së cilësive të caktuara me ligj, merren me dy të tretat e votave të mbledhjes përkatëse.

Art. 30. Deputetët përpara se të fillojnë detyrën betohen në këtë mënyrë: **“Betoem botërisht, në emër të Perëndisë, që, si deputet i Shqipërisë do të jem besnik i Statutit, do të punoj me nder e me ndërgjegje për të mirën e Atdheut”**.

Art. 31. Deputeti që pa lejen e Parlamentit mungon në mbledhje dy muaj rradhazi, quhet menjëherë i rrëzuar nga deputetësia.

Art. 32. Në fillim të çdo Legjislature, si edhe në hapjen e çdo sesioni të zakonshëm, Parlamenti zgjedh nga gjiri i tij Kryetarin, Nënkryetarin dhe anëtarët e Kryesisë, sipas dispozitave të rregullores së brendshme.

Art. 33. Administrimi i Zyrave të Parlamentit ushtrohet sipas rregullores së brendshme të tij. Buxheti i Parlamentit hartohet prej Kryesisë dhe votohet prej mbledhjes rregullisht.

Art. 34. Kur për çdo arsye të mundshme mbetet i lirë vendi i një deputeti, brenda dy muajsh prej ditës së lirimit të vendit, por jo më parë se një muaj, duhet zgjedhur një tjetër në vendin e lirë.

Art. 35. Në mbarim të periudhës, ose në rast të shpërndarjes së Parlamentit, Pushteti Përmbaues detyrohet brenda dy javësh prej ditës së shpërndarjes së tij të dekretojë zgjedhjet e reja, të cilat duhen zhvilluar jo më vonë se dy muaj e gjysmë e jo më parë se një muaj prej datës së dekretit.

Art. 36. Parlamenti i rizgjedhur mblidhet menjëherë dhjetë ditë pas zgjedhjeve. Kur kjo mbledhje takon brenda kohës së sesionit të zakonshëm, vazhdon deri në mbarim të këtij, por kur takon jashtë sesionit të zakonshëm kjo mbledhje quhet speciale dhe diskuton vetëm mbi shqyrtimin, legalizimin e kompetencave të pjesëtarëve të vet e pasi zgjedh Kryesinë dhe diskuton mbi votëbesimin e Qeverisë, ndërpret punimet deri në fillim të sesionit të ardhshëm.

Kur zgjedhjet e reja qëllojnë jo më larg se një muaj para kohës së fillimit të sesionit të zakonshëm, Parlamenti i ri mblidhet ditën e caktuar për hapjen e sesionit.

Art. 37. Parlamenti mblidhet edhe në sesione të jashtëzakonshme, kur kërkohet prej Mbretit. Në këto sesione diskutohen vetëm ato çështje që janë caktuar prej Pushtetit Përmbaues në dekretin e mbledhjes.

Art. 38. Mbledhjet dhe diskutimet e Parlamentit mbahen botërisht në përputhje me rregulloren e brendshme.

Diskusimet botohen pikërisht në volume të posaçme.

Art. 39. Parlamenti mund të diskutojë edhe në mbledhje me dyer të mbyllura, në goftë se kërkohet prej ministrave; gjithashtu edhe kur kërkohet prej pesë deputetëve dhe

pranohet prej shumicës në një mbledhje të fshehtë. Në këto mbledhje, salla e Parlamentit boshatiset prej të gjithë atyre që nuk janë deputetë.

Art. 40. Parlamenti nuk mund të diskutojë e të vendosë pa qenë të pranishëm më shumë se gjysma e pjesëtarëve të tij.

Art. 41. Të gjitha vendimet votohen me shumicë absolute të deputetëve që gjenden të pranishëm, përveç rasteve që në Statut urdhërohet ndryshe. Në barazim të votave fiton ana e Kryetarit.

Votimet që bëhen për zgjedhje personash, në qoftë se herën e parë nuk përfundojnë me shumicën absolute të deputetëve të mbledhur, herën e dytë bëhen me shumicë relative.

Art. 42. Votimi i ligjeve bëhet një herë parimisht e dy herë nen për nen në tre ditë të ndryshme. Kodet e paraqitura prej Qeverisë dhe të përgatitura prej një Komisioni të posaçëm, të krijuar me ligj, pasi të pranohen në parim, votohen bashkërisht (en bloc) në dy mbledhje në ditë të ndryshme; kur Parlamenti sheh të arsyeshme nevojën e modifikimit, ia referon Komisionit të posaçëm me anë të Qeverisë.

Ligjet, që me vendim të Parlamentit quhen të ngutshme, votohen sipas rregullores së brendshme.

Art. 43. Parlamenti është i padhunueshëm; asnjë forcë e armatosur nuk mund të rrijë përreth ose brenda Parlamentit pa kërkesën dhe vendimin e tij, përveç rojës që është nën urdhrin ekskluziv të Kryesisë së Parlamentit.

Art. 44. Çdo ligj i votuar prej Parlamentit i paraqitet Pushtetit Përmbaues për miratim e për shpallje.

Shpallja do të bëhet të shumtën dy javë pas miratimit; ligjet hyjnë në fuqi një muaj pas shpalljes, përveç rasteve, kur ligjet caktojnë një afat të ndryshëm për hyrjen e tyre në fuqi.

Art. 45. Çdo projektligj që refuzohet prej Parlamentit, kur është i propozuar prej Pushtetit Përmbaues, i kthehet këtij të fundit duke i shpjeguar edhe arsyet e mosmiratimit.

Art. 46. Projektligjet që s'miratoohen prej Parlamentit nuk mund të paraqiten për diskutim herën e dytë po në atë sesion.

Art. 47. Parlamenti kontrollon Qeverinë. Pyetja, interpelanca, anketa janë ndër kompetencat dhe të drejtat e Parlamentit; mënyra e zbatimit të tyre caktohet me rregulloren e brendshme.

Art. 48. Për tradhti të lartë, si edhe për krime të parashikuara në ligjin e posaçëm mbi përgjegjësinë e Ministrave, Parlamenti akuzon ministrat dhe me 3/5 (tre të pestat) e votave të numrit të përgjithshëm, i dërgon përpara Gjyqit të Lartë të Shtetit.

Art. 49. Askush nuk mund të marrë fjalën në mbledhjet e Parlamentit përveç deputetëve dhe ministrave.

## **Kapitulli II**

### **Pushteti Përmbaues**

#### **Pjesa A**

#### ***MBRETI***

Art. 50. Mbreti i shqiptarëve është Lart-Madhëria e tij **Zogu I**, nga familja e famshme shqiptare Zogu.

Art. 51. Trashëgimi i Fronit Mbretëror i përket djalit më të madh të Mbretit, dhe trashëgimia vazhdon brez pas brezi në vijë direkte, mashkull pas mashkullit.

Art. 52. Kur trashëgimtari vdes ose humbet të drejtat e trashëgimtarisë, fronti trashëgohet prej djalit më të madh të Tij.

Në rast se trashëgimtari vdes ose humbet të drejtat e trashëgimtarisë pa pasur djalë, trashëgimi i shkon vëllait që vjen pas Tij.

Art. 53. Në rast se nuk ekziston trashëgues për Fronin Mbretëror, sipas dispozitave të neneve 51 e 52, Mbreti zgjedh prej meshkujve të fisit të vet trashëgimtarin e Fronit me miratimin e Parlamentit.

Kur Mbreti nuk e përdor këtë të drejtë dhe trashëgimtaria mbetet vakant, atëherë Parlamenti zgjedh vetë trashëgimtarin e Fronit, prej meshkujve të fisit të Mbretit.

Në rast se nuk ekziston prej këtij fisi, ose personat që ndodhen, me një vendim të posaçëm të Parlamentit të marrë me dy të tretat e votave të numrit të përgjithshëm, nuk shihen të aftë për trashëgimi, atëherë Parlamenti zgjedh trashëgimtarin nga meshkujt e gjinisë prej barkut të bijave ose motrave të Mbretit, por kurdoherë me origjinë shqiptare.

Kur mungon mashkull prej gjinive të sipërmendura, atëherë Parlamenti zgjedh trashëgimtarin me origjinë shqiptare.

Në rast se mbetet froni vakant pa u zgjedhur trashëgimtari, deri në zgjidhjen e çështjes, kompetencat mbretërore ushtrohen prej Këshillit të Ministrave.

Art. 54. Mbreti është madhor kur të ketë mbushur 18 vjeç.

Art. 55. Mbreti fillon ushtrimin e Pushtetit Mbretëror pasi betohet në mënyrën e treguar në art. 56 para Parlamentit.

Art. 56. Mbreti para Parlamentit betohet si vijon: “ **Unë (.....), Mbreti i Shqiptarëve, në minutën që hyp në fronin e Mbretërisë Shqiptare dhe marr në dorë pushtetet mbretërore, betohem para Zotit Fuqimadh, se do të ruaj njësinë kombëtare, pavarësinë shtetërore dhe tërësinë tokësore; gjithashtu, do t'i përmbahem Statutit e do të veproj pikërisht sipas atij dhe sipas ligjeve në fuqi, duke pasur parasysh gjithmonë të mirën e popullit. Perëndia më ndihmoftë**”.

Vetëm këtë herë, Mbreti i I-rë, LartMadhëria e Tij ZOGU I, betohet para Asamblesë Kushtetuese.

Art. 57. Në rastin e vdekjes ose dorëheqjes (abdication) të Mbretit, parlamenti mblidhet menjëherë brenda dhjetë ditëve për të dëgjuar betimin e Mbretit të Ri ose të Regjencës; kur Parlamenti ndodhet i shpërndarë dhe Parlamenti i ri nuk është zgjedhur, mblidhet i vjetri për të kryer këtë detyrë.

Derisa të bëhet betimi i Mbretit të Ri ose i Regjencës, Pushteti Konstitucional Mbretëror, në emër të popullit shqiptar ushtrohet prej Këshillit të Ministrave nën përgjegjësinë e tij.

Art. 58. Kur konstatohet prej Parlamentit, bashkërisht me Qeverinë, se Mbreti gjendet në pamundësi për të kryer detyrën ose vdes Mbreti e duke qenë se trashëgimtari është i mitur, Pushteti Mbretëror ushtrohet prej Regjencës në emër të Mbretit.

Në rast të paraparë në këtë artikull, tutoria i përket Regjencës.

Art. 59. Ushtrimi i Regjencës i përket trashëgimtarit të fronit, kur ky është madhor.

Në rast se trashëgimtari i Fronit, për shkaqet e parashqyrtuara në art. 58 nuk mund të ushtrojë detyrën e Regjencës, kjo e fundit formohet në këtë mënyrë:

a) Prej Mbretëreshës (kur Mbreti është në pamundësi), ose prej Nënës Mbretëreshë (kur Mbreti është i mitur);

b) Prej kryetarit të Parlamentit;

c) Prej Kryeministrit;

d) Prej Kryetarit të Këshillit të Shtetit.

Art. 60. Kur nuk ka Mbretëreshë dhe Nënë Mbretëreshë, Këshilli i Regjencës formohet vetëm prej tre anëtarëve të tjerë që përmenden në art. 59 të këtij Statuti.

Art. 61. Kur Këshilli i Regjencës ndodhet i formuar, sipas art. 59, me katër anëtarë dhe mungon ose ndodhet i penguar përkohësisht njëri prej tyre, tre të tjerët; dhe kur është i formuar me tre, dy të tjerët ushtrojnë punët shtetërore.

Art. 62. Regjentët nuk mund të fillojnë detyrën pa bërë betimin e duhur para Parlamentit; betimi i këtyre do të përmbajë besnikërinë kundrejt Mbretit, Statutit dhe ligjeve të Shtetit.

Art. 63. Kur Mbreti vdes pa lënë trashëgimtar, por Mbretëresha në minutën e vdekjes së Tij është shtatzënë, e cila konstatohet me raportin e tre mjekëve të autorizuar prej Këshillit të Ministrave, formohet Këshilli i Regjencës përkohësisht, i cili ushtron Pushtetin Mbretëror deri në lindjen e foshnjës.

Art. 64. Në rast se vdes trashëgimtari i Fronit, pa lënë djalë, por në minutën e vdekjes e shoqja është shtatzënë, gjë që konstatohet nga formalitetet zyrtare, të përshkruara në art. 63, për deklarimin e trashëgimtarit pritet lindja e foshnjës.

Art. 65. Mbreti banon kurdoherë në Shqipëri; kur përkohësisht del jashtë Shqipërisë, trashëgimtari i fronit ushtron Pushtetin Mbretëror. Në qoftë se trashëgimtari nuk është madhor ose gjendet në pamundësi për të ushtruar pushtetin, Këshilli i Ministrave, nën përgjegjësinë e vet ushtron pushtetin në fjalë. Mbreti nuk mund të qëndrojë jashtë Shqipërisë më tepër se tre muaj.

Ushtrimi i Pushtetit Mbretëror në raste të tilla, si nga ana e trashëgimtarit ashtu edhe nga Këshilli i Ministrave, do të kryhet sipas porosive urdhërore të Mbretit, të dhëna brenda kufijve të Statutit.

Art. 66. Dispozitat e artikullit 65 mund të zbatohen edhe në rast se Mbreti ndodhet i sëmurë, por jo në shkallën e pamundësisë së përhershme.

Art. 67. Kur Këshilli i Ministrave ushtron Pushtetin Mbretëror, ai nuk ka të drejtë të shpërndajë Parlamentin.

Art. 68. Ushtrimi i Pushtetit Mbretëror nga ana e Këshillit të Ministrave, në çdo rast, nuk mund të vazhdojë më tepër se tre muaj; në mbarim të kësaj kohe formohet Këshilli i Regjencës.

Art. 69. Regjentët, në ushtrimin e veprimeve të këtij Këshilli, janë të papërgjegjshëm.

Art. 70. Froni Mbretëror i Shqipërisë nuk mund të bashkohet me fronin e një Mbretërie tjetër.

Art. 71. Mbreti është kreu më i lartë i Shtetit; Ai zotëron gjithë kompetencat dhe të drejtat e Fronit, të dhëna në këtë Statut, të cilat i ushtron me anën e Ministrave, sipas dispozitave të këtij Statuti.

Ai është komandanti më i lartë i forcave tokësore, detare dhe ajrore të Shtetit, të cilat i ushtron drejtpërdrejt sipas dispozitave të posaçme të titullit V të këtij Statuti.

Art. 72. Mbreti është i pacenueshëm dhe i papërgjegjshëm. Ministrat e tij janë përgjegjës.

Art. 73. Përveç akteve që i përkasin Komandës së Lartë, çdo akt tjetër i Mbretit, për të qenë i vlefshëm dhe i zbatueshëm duhet të ketë bashkëngjitur firmën e Kryeministrit dhe të Ministrit kompetent.

Art. 74. Mbreti sanksionon (sanctionner), urdhëron shpalljen dhe nxjerrjen (promulguer) e ligjeve të votuara prej Parlamentit.

Mbreti mund të refuzojë miratimin (sancion); Ai mund të kërkojë edhe një diskutim të dytë mbi ligjet e paraqitura duke shënuar shkaqet e mosmiratimit.

Në qoftë se Mbreti, brenda tre muajve, që prej datës së paraqitjes, nuk prononcohet dhe nuk përdor të drejtat e mësipërme, ligjet e paraqitura për miratim quhen të refuzuara.

**Art. 75.** Mbreti emëron dhe çemëron Kryeministrin dhe Ministrat e zgjedhur prej këtij.

**Art. 76.** Mbreti ka të drejtë të akuzojë Ministrat dhe t'i dërgojë në Gjyqin e Lartë.

**Art. 77.** Mbreti, në çdo rast që e sheh të nevojshme, ka të drejtë të mbledhë Këshillin e Ministrave, i cili diskuton dhe vendos nën kryesinë e Tij.

**Art. 78.** Mbreti ka të drejtë të dekretojë rregullore që shpjegojnë mënyrën e zbatimit të ligjeve; këto rregullore nuk mund të përmbajnë dispozita të reja që nuk i përfshin ligji.

**Art. 79.** Mbreti ka të drejtën e faljes (grace). Ai ka të drejtë të lehtësojë (reduire) dhe të ndryshojë (commuer) dënimet definitive të dhëna prej gjyqeve.

Ai ka të drejtë të urdhërojë pezullimin e ndjekjeve ligjore vetëm ndër faje politike.

Mbreti nuk mund të falë Ministrat e dënuar për faje që rrjedhin nga detyra, pa marrë miratimin e Parlamentit.

Amnistia bëhet vetëm me miratimin e Parlamentit; kjo nuk cenon të drejtat private.

**Art. 80.** Mbreti emëron dhe çemëron nëpunësat e Shtetit dhe jep grada ushtarake, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

**Art. 81.** Mbreti përfaqëson Shtetin Shqiptar brenda e jashtë; Ai pranon dhe akrediton trupa diplomatikë.

**Art. 82.** Mbreti shpall luftë në rast mbrojtjeje; shpallja e luftës jashtë kushtit të mbrojtjes dhe lidhja e paqes bëhen pas miratimit të Parlamentit.

**Art. 83.** Mbreti lidh traktate miqësie, aleance e të tjera dhe për këto e vë në dijeni Parlamentin, në një kohë për sa e lejon interesi i lartë i Shtetit.

Traktatet tregtare dhe ato traktate të tjera që mund të ngarkojnë Shtetin ose personalisht shtetasit shqiptarë me taksa të reja, nuk kanë vlerë dhe efekt pa u miratuar edhe prej Parlamentit.

**Art. 84.** Dispozitat e fshehta të traktateve, në asnjë mënyrë, nuk mund t'i anullojnë dispozitat e hapura të çdo traktati.

**Art. 85.** Vetëm Mbreti ka të drejtë të akordojë dekorime dhe të shtypë monedhë sipas ligjeve.

**Art. 86.** Dekorimet që u akordohen shtetasve shqiptarë nga të huajt, nuk mund të pranohen as nuk mund të mbahen, veçse me lejen e posaçme të Mbretit.

**Art. 87.** Shpërblim paguhet vetëm: për Mbretin, Nënë e Mbretit, Trashëgimtarin e Fronit, djemtë e mitur dhe vajzat e pamartuara ose të veja të Mbretit të vdekur, ashtu edhe për Regjentët në kohën kur funksionojnë.

Shpërblimi i Mbretit është 500.000 (pesëqindmijë) franga ari në vit; kjo shumë mund të ndryshohet herë pas here me ligj.

Sasia e shpërblimit të të tjerëve caktohet me ligj.

**Art. 88.** Personeli i Oborrit Mbretëror dhe detyrat e tyre caktohen me ligj të posaçëm. Emërimi dhe çëmërimi i tyre i përket drejtpërdrejt Mbretit.

**Art. 89.** Martesa e Mbretit dhe e Trashëgimtarit lidhen vetëm me pëlqimin e Parlamentit.

**Art. 90.** Kur Trashëgimtari i Fronit marrohet pa lejen e Parlamentit, ai dhe djemtë që lindin prej kësaj martese, humbasin të drejtat e trashëgimisë.

Gjithashtu, kur Trashëgimtari është i pazoti ose ka sjellje të papajtueshme me cilësinë e detyrës së tij të lartë, Parlamenti në marrëveshje me Mbretin mund të vendosë, me dy të tretat e votave të mbledhjes, rrëzimin e tij nga trashëgimia.

**Art. 91.** Në hapjen e sesionit Parlamentar të zakonshëm dhe në fillim të çdo legjislature, Mbreti me një ligjëratë të Fronit, personalisht, ose me një mesazh të cilin e lexon Kryeministri, shpjegon gjendjen e përgjithshme të vendit dhe masat që shihen të nevojshme për t'u marrë atë vit.

Parlamenti i jep një përgjigje sa më shpejt.

Ligjëratat e Fronit ose mesazhi duhet të jetë i nënshkruar prej Kabinetit.

**Art. 92.** Mbreti mund të urdhërojë hapjen e sesionit të zakonshëm edhe para kohës së caktuar në këtë Statut; por kjo thirrje nuk mund të bëhet më shumë se një muaj para kohës së caktuar.

Gjithashtu mund të urdhërojë edhe hapjen e sesioneve të jashtëzakonshme, të cilat duhet të mbyllen para se të fillojnë sesionet e zakonshme.

**Art. 93.** Mbreti mbyll sesionet me dekretin e Tij, i cili lexohet në Parlament nga ana e Qeverisë. Ky dekret duhet të jetë i nënshkruar prej Kabinetit.

**Art. 94.** Mbreti ka të drejtë të shtyjë fillimin e sesionit, të pezullojë mbledhjen brenda në një sesion dhe të zgjasë vijimin e sesionit.

Kjo e drejtë nuk mund të përdoret dy herë radhazi brenda në një sesion dhe koha e shtyrjes, pezullimit dhe e zgjatjes nuk mund të jetë më shumë se një muaj. Dekretet përkatës do të jenë të nënshkruar prej Kabinetit.

**Art. 95.** Mbreti, kur e shih të nevojshme, ka të drejtë të shpërndajë Parlamentin. Në këtë rast veprohet sipas artikujve 35, 36 të këtij Statuti. Dekreti i shpërndarjes duhet të jetë i nënshkruar prej Kabinetit.

**Art. 96.** Kur Parlamenti nuk ndodhet i mbledhur dhe shfaqen nevoja tepër urgjente të justifikuara, Mbreti nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave ka të drejtë të hartojë dekretligje, të cilat në hapjen e sesionit më të afërt, brenda 15 ditëve, duhet t'i paraqiten Parlamentit, bashkë me raportin justifikues, për diskutim e shqyrtim.

Në qoftë se nuk paraqiten brenda kësaj kohe ose nuk miratohen nga Parlamenti, quhen menjëherë të rrëzuara. Me dekretligj nuk mund të shfuqizohen dhe të modifikohen kodet.

**Art. 97.** Në rast lufte ose ndonjë situatë luftësjetllëse, në kohë kryengritjeje dhe mobilizimi të përgjithshëm ose fatkeqësie, Mbreti, nën përgjegjësinë e Kabinetit, ka të drejtë të shpallë shtetrrëthimin pjesërisht ose të përgjithshëm.

Dekreti i shtetrrëthimit, brenda 24 orëve, i paraqitet Parlamentit për miratim.

Në qoftë se Parlamenti ndodhet në pushim dekreti i shtetrrëthimit, do t'i paraqitet Parlamentit në sesionin më të afërt dhe jo më vonë se tre ditë pas ditës së hapjes. Parlamenti diskuton dhe vendos brenda një jave.

Shtetrrëthimi përkohësisht kufizon dhe pezullon lirinë personale, padhunueshmërinë e banesës, të drejtën e shoqatës dhe të mbledhjeve, lirinë e shtypit dhe fshehtësinë e letrave e lirinë e fjalës.

Një ligj i posaçëm do të rregullojë mënyrën e kufizimit dhe të ndalimit të të drejtave të mësipërme dhe do të caktojë, bashkë me zonën e shtetrrëthimit edhe mënyrën e zbatimit të dispozitave që do të aplikohen brenda zonës së shtetrrëthimit.

**Art. 98.** Mbreti mban titullin "Lartmadhëria e Tij" (Sa Majeste) Trashëgimtari "Princi i Shqiptarëve" Lartësia e Tij (Son Altesse), Nënë Mbretëreshë dhe Mbretëresha "Lartmadhëria Saj"; Vëllezërit nga Ati dhe djemtë e Mbretit "Princ". Motrat nga Ati dhe Bijat e Tij "Princeshë"; këta dy titujt e fundit nuk trashëgohen dhe në rast nevojë mund të hiqen me dekret Mbretëror.

Përveç këtyre, as mund të akordohen, as mund të mbahen nga shqiptarët tituj fisnikërie në Shqipëri.

## **PJESA B**

### **Ministrat**

**Art. 99.** Në krye të shërbimeve shtetërore, i varur (soumis) drejtpërdrejt nga Mbreti, funksionon Këshilli i Ministrave, i cili përbëhet prej Kryeministrit dhe Ministrave.

**Art. 100.** Këshilli i Ministrave kryesohet prej Kryeministrit. Ministrat administrojnë shërbimet e ndryshme shtetërore sipas titullit që ata mbajnë.

**Art. 101.** Askush nuk mund të emërohet Ministër pa qenë nga raca e gjaku shqiptar dhe që nuk di gjuhën shqipe.

Të huajt prej origjine, me nënshtetësi shqiptare shqiptarë, nuk mund të emërohen Ministra.

Gjithashtu, nuk mund të emërohen Ministra edhe ata që s'kanë cilësitë e kërkuara prej ligjit për t'u zgjedhur deputet.

**Art. 102.** Asnjë nga pjesëtarët e familjes Mbretërore nuk mund të emërohet Ministër.

**Art. 103.** Nuk mund të emërohen Ministra në një Kabinet, të afërmit prej gjaku deri në brezni të tretë.

**Art. 104.** Ministrat, pa e marrë ende detyrën betohen përpara Mbretit. Ky betim do të përmbajë besnikërinë kundrejt Mbretit dhe Statutit e ligjeve të Shtetit.

**Art. 105.** Ministrat emërojnë dhe çemërojnë nëpunësit që kanë vartës, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

**Art. 106.** Ministrinë krijohen me ligj.

**Art. 107.** Ministrat hyjnë lirisht në Parlament dhe dëgohen çdo herë që kërkojnë fjalën, por votojnë vetëm ata që janë edhe deputetë.

**Art. 108.** Urdhri i mbretit asnjëherë nuk mund t'i shkarkojë Ministrat prej përgjegjësisë së tyre.

**Art. 109.** Kabineti është përgjegjës në mënyrë solidare kundrejt Mbretit dhe Parlamentit për çështjet që i përkasin politikës së përgjithshme të Shtetit; dhe veçanërisht çdo Ministër është përgjegjës për veprimet që i përfshin kompetenca e tij

**Art. 110.** Ministrat nuk mund të akuzohen për fajet e parashqyrtura në ligjin e posaçëm, pas katër vjetëve të largimit të tyre nga detyra.

**Art. 111.** Ministrat quhen të rrëzuar, kur vendoset dërgimi i tyre në Gjyqin e Lartë.

**Art. 112.** Kabineti duhet të paraqitet para Parlamentit për të marrë votëbesimin brenda një jave prej ditës së emërimit; përndryshe, konsiderohet sikur ka marrë votëmosbesimin. Në qoftë se Parlamenti nuk ndodhet i mbledhur, marrja e votëbesimit, bëhet në mbledhjen më të afërt të tij.

Këtë herë votëbesimin e merr prej Asamblesë Kushtetuese.

**Art. 113.** Kabineti që nuk merr votëbesimin prej Parlamentit detyrohet t'i paraqesë Mbretit dorëheqjen.

**Art. 114.** Në rast se Kryeministri jep dorëheqjen ose i hiqet mandati, Kabineti i kryesuar prej tij quhet i rrëzuar menjëherë.

**Art. 115.** Ministrat gëzojnë imunitetin parlamentar.

**Art. 116.** Kabineti mund t'i tërheqë projektet e paraqitura prej tij dhe që janë të pavotuara përfundimisht prej Parlamentit.

**Art. 117.** Projektligjet e propozuara prej Pushtetit Përmbarues i paraqiten Pushtetit Legjislativ me anën e Kryeministrit, pasi të jenë miratuar prej Këshillit të Ministrave.

### **Kapitulli III**

#### **Pushteti Gjyqësor**

#### **PJESA A**

#### **Gjyqet**

**Art. 118.** Organizimi, të drejtat dhe kompetencat e gjyqeve, caktohen me ligj.

Gjyqtarët, në dhënien e vendimeve, janë të pavarur dhe udhëhiqen vetëm prej ligjit e ndërgjegjes së tyre; askush nuk mund të ndërhyjë dhe të ndikojë në dhënien e vendimeve gjyqësore.

**Art. 119.** Vendimet e gjyqeve nuk mund të ndryshohen dhe ekzekutimi i tyre nuk mund të ndalohet ose të pezullohet prej asnjë pushteti tjetër, qoftë Legjislativ ose Përmbarues, veç në raste të parashikuara prej këtij Statuti.

**Art. 120.** Gjyqtarët dhe Prokurorët e Shtetit janë të paprekshëm në mënyrën e caktuar në ligjin organik; cilësitë e gjyqtarëve, të prokurorëve të Shtetit dhe mënyra e emërimit, transferimit, pushimit, gradimit, çgradimit, pezullimit dhe e pensionimit, ashtu si edhe vlefata e rrogave dhe e shpërblimeve të tyre, caktohen me ligjin organik të drejtësisë.

Kjo dispozitë zbatohet një vit pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti.

**Art. 121.** Gjyqtarët, veç të drejtave dhe detyrave të caktuara me ligj, janë të ndaluar rreptësisht të marrin përsipër nëpunësi dhe detyra të tjera publike ose private.

**Art. 122.** Çdo person ka të drejtë të mbrojtë të drejtat e veta me mënyrat e pranueshme prej ligjit.

**Art. 123.** Gjyqet mund të zhvillohen me dyer të hapura përveç rasteve të veçanta kur ligjet e shohin të arsyeshme të jenë me dyer të mbyllura në interesin e rendit publik dhe të qetësisë publike.

**Art. 124.** Gjyqtarët, diskutimet dhe votimet i bëjnë fshehtas, por vendimet e dhëna i shpallin (prononcer) botërisht sipas ligjit.

**Art. 125.** Vendimet e gjyqit duhet të përmbajnë arsyet ligjore dhe nenet e ligjeve në të cilat mbështeten.

**Art. 126.** Në asnjë mënyrë nuk mund të formohen gjykata të jashtëzakonshme. Vetëm për faje politike, kur shihet nevoja, mundet të formohet një gjykatë e posaçme me ligj të veçantë dhe për një kohë të caktuar.

**Art. 127.** Asnjë gjyq, nuk mund të refuzojë shqyrtimin e çështjeve që janë në kompetencën dhe detyrën e tij.

Kur gjyqi konsideron se ndonjë çështje është jashtë kompetencës dhe detyrës së vet, ai refuzon shqyrtimin e saj me vendim të rregullt.

**Art. 128.** Gjykimi i të pandehurit përpara gjykatave, për një krim që sjell ndëshkim kundër lirisë personale, maksimumi i të cilit nuk i kalon tre vjet, nuk mund të bëhet veçse me asistencën e një avokati mbrojtës, të zgjedhur prej të pandehurit vetë. Në rast se i pandehuri nuk emëron avokat mbrojtës atë e emëron gjykata sipas ligjit. Marrja në pyetje e të pandehurit në raste të tilla në gjykatat hetuese, mund të bëhet në praninë e avokatit mbrojtës, të emëruar prej të pandehurit.

**Art. 129.** Të gjithë gjyqtarët e prokurorët e Shtetit, të zgjedhur dhe të propozuar sipas ligjit të posaçëm emërohen me dekret të Mbretit.

**Art. 130.** Shqipëria ka një Gjyq Diktimi, i cili ndahet në degë sipas ligjit të posaçëm. Qendra e gjyqit të Diktimit, është në Kryeqytet.

**Art. 131.** Mënyra e marrjes së masave kundra gjyqtarëve dhe prokurorëve caktohet me ligj të posaçëm.

**Art. 132.** Kryetarët, anëtarët, ndihmës-anëtarët e Diktimit dhe kryeprokurori i Shtetit, për fajet e rrjedhura nga detyra ose në detyrë e sipër, gjykohen në Gjyqin e Lartë të Shtetit.

Hetimet e para bëhen prej Ministrisë kompetente dhe vendimi i dërgimit në gjyq, jepet prej Parlamentit.

**Art. 133.** Gjyqtarët, duke përjashtuar ata të Diktimit dhe prokurorët e Shtetit, për fajet e rrjedhura nga detyra ose në detyrë e sipër, gjykohen në Gjykatën e Diktimit, sipas ligjit dhe pasi të jenë kryer formalitetet akuzuese sipas ligjit të posaçëm.

**Art. 134.** Vendimet mbi dërgimin në gjyq të gjyqtarëve dhe të prokurorëve të Shtetit, sjellin menjëherë pezullimin nga detyra.

## **PJESA B**

### **Gjyqi i Lartë i Shtetit**

**Art. 135.** Për të gjykuar Ministrat dhe kryetarët, anëtarët, ndihmësanëtarët e Diktimit, të Këshillit të Shtetit, të Këshillit Kontrollues si edhe Kryeprokurorin e Shtetit, për fajet e kryera gjatë detyrës ose në detyrë e sipër, formohet Gjyqi i Lartë i Shtetit.

**Art. 136.** Gjyqi i Lartë i Shtetit, formohet me dekret Mbretëror, kur të shihet nevoja.

**Art. 137.** Gjyqi i Lartë i Shtetit përbëhet prej Kryetarit të Diktimit të Degës Penale, i cili edhe e kryeson, prej katër anëtarëve të Diktimit dhe katër anëtarëve të Këshillit të Shtetit, të cilët zgjidhen me short midis tyre në një mbledhje të veçantë.

**Art. 138.** Detyra e prokurorisë kryhet prej Kryeprokurorit të Shtetit.

**Art. 139.** Vendimet e këtij Gjyqi merren me dy të tretat e votave dhe janë të formës së prerë.

**Art. 140.** Gjyqi i Lartë gjykon e vendos sipas ligjeve në fuqi të Shtetit.

## **Titulli III**

### **Financat e Shtetit**

#### **Kapitulli I**

##### **Financat**

**Art. 141.** Taksa është një detyrim i popullit për t'i bërë ballë shpenzimeve të përgjithshme të Shtetit.

**Art. 142.** Asnjë taksë, e çdo lloji qoftë, nuk mund të caktohet dhe të mblidhet veçse me ligj.

Vetëm kur është e detyrueshme apo rritet taksa doganore, kjo praktikohet prej ditës së paraqitjes para Parlamentit të projektligjit relativ në zarf të mbyllur, i cila duhet të votohet brenda 15 ditëve. Kur taksa doganore zbritet, ligji relativ hyn në fuqi, dy muaj pas shpalljes së tij.

**Art. 143.** Ligji nuk mund të krijojë taksa veçse në favor të Shtetit, të Prefekturave (provinca), të Komunave, të Bashkive dhe të Institucioneve Publike.

Taksat në favor të Prefekturave (provinca) e të Komunave krijohen pasi të merret pëlqimi i Këshillave të vendit.

**Art. 144.** Nuk mund të krijohen privilegje mbi taksat. Asnjë shkarkim nga detyrimet (exemption), modifikim apo abrogim takse nuk mund të bëhet veçse me ligj.

Nuk mund të krijohen monopole veçse me ligj dhe ekskluzivisht në favor të Shtetit dhe të Bashkive.

**Art. 145.** Asnjë fond për pensione ose shpërblime (gratification) nuk mund t'i ngarkohet Shtetit veçse me ligj.

**Art. 146.** Pushteti Përmbarues, brenda muajit Janar të çdo viti i paraqet Parlamentit buxhetin parashikues, i cili votohet kapitull për kapitull dy herë në dy ditë të ndryshme; në këtë buxhet përfshihen të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e Shtetit bashkë me ligjet relative, mbi të cilat bazohen të ardhurat.

Pas mbarimit të vitit financiar dhe brenda muajit Gusht, Ministria e Financave është e detyruar t'i referojë Buxhetin e Konsumit të vitit të kaluar Këshillit Kontrollues, i cili pasi e shqyrton i paraqet Parlamentit brenda muajit Nëntor, raportin relativ me gjithë vrojtimet e duhura. Në të njëjtën kohë, Buxheti i Konsumit i shqyrtuar kësisoj, bashkë me raportin shqyrtues të Këshillit Kontrollues, i paraqitet Kryeministrisë, e cila ia parashtron Parlamentit për aprovim.

Buxheti i Konsumit, votohet një herë përgjithësisht.

**Art. 147.** Në rast se Buxheti Preventiv nuk votohet deri më 31 Mars, Pushteti Përmbarues është i autorizuar të vërë në ekzekutim buxhetin e vitit të kaluar për aq kohë sa do të vonohet votimi i buxhetit të paraqitur.

**Art. 148.** Kur një kredi e shënuar në buxhet nuk mjafton për shërbimin që është caktuar ose kur shfaqen nevoja për shpenzime për shërbime të paparashqyrtuara në buxhet, Pushteti Përmbarues me një projektligj kërkon prej Parlamentit shtimin ose dhënien e asaj kredie; Pushteti Përmbarues detyrohet të tregojë mënyrën e përballimit të këtyre shpenzimeve.

**Art. 149.** Asnjë hua nuk mund të kontraktohet në dobi të Shtetit pa ligj autorizues.

**Art. 150.** Asnjë objekt prej pasurisë së patundshme të Shtetit nuk mund të tjetërsohet, si edhe nuk mund të shfrytëzohet për një kohë më shumë se njëzet vjet, veçse me miratimin e Parlamentit.

**Art. 151.** Pasuria minerale është e ndarë në dy grupe: Miniera e Gurore; të parat janë prona të Shtetit dhe të dytat janë prona të zotëruesve të sipërfaqes së tokës. Shfrytëzimi i tyre bëhet sipas ligjit relativ.

**Art. 152.** Ujërat, burimet minerale rregullohen me ligj të posaçëm; të drejtat e fituara mbi to janë të respektuara.

### **Kapitulli III**

#### **Këshilli Kontrollues**

**Art. 153.** Financat e Shtetit kontrollohen prej Këshillit Kontrollues, i cili në ushtrimin e detyrës është i pavarur.

**Art. 154.** Këshilli Kontrollues përbëhet prej një Kryetari dhe dy anëtarëve; organizimi, mënyra e ushtrimit të kompetencave të tij dhe cilësitë e atyre që e përbëjnë caktohen në ligjin e posaçëm.

**Art. 155.** Kontrollimi preventiv si edhe kontrollimi konsumtiv i gjithë të ardhurave dhe harxhimeve të Shtetit bëhen prej Këshillit Kontrollues.

Çdo vit, Këshilli Kontrollues i paraqet Parlamentit një raport të përgjithshëm që përmban llogaritë e buxhetit të vitit të kaluar dhe shënon çrregullimet që mund të kanë ndodhur në administratat e ndryshme të Shtetit në zbatimin e buxhetit.

**Art. 156.** Këshilli Kontrollues, në çdo tre muaj, me një raport të veçantë i parashtron Mbretit gjendjen financiare të Shtetit, përmes Kryeministrisë.

**Art. 157.** Kryetari dhe anëtarët e këtij Këshilli emërohen prej Mbretit midis kandidatëve dyfish, të zgjedhur prej Komisionit të Posaçëm, i përbërë prej Kryeministrit, Kryetarit të Parlamentit dhe Ministrit të Financave. Nëpunësit e tjerë të këtij Këshilli emërohen sipas ligjit.

**Art. 158.** Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Kontrollues, për faje gjatë detyrës ose në detyrë e sipër, akuzohen dhe dërgohen në Gjyqin e Lartë, me vendimin e Parlamentit.

**Art. 159.** Anëtarët e Këshillit Kontrollues para se të fillojnë detyrë bëjnë betimin e duhur para Mbretit. Këta emërohen për një periudhë shtatëvjeçare, e cila fillon për çdo anëtar që prej datës së dekretit. Imunitetit i tyre brenda kësaj kohe është i siguruar, përveç rasteve të parashikuara në ligjin e pensionit dhe kur vendoset prej Parlamentit pushimi ose dërgimi i tyre në Gjyqin e Lartë.

#### **Titulli IV**

##### **Këshilli i Shtetit**

**Art. 160.** Për të ushtruar detyrat e caktuara në këtë Statut, si edhe në ligjet e posaçme, do të formohet një Këshill Shteti.

**Art. 161.** Trupi i Këshillit të Shtetit përbëhet prej dhjetë anëtarësh dhe dy ndihmësanëtarë.

**Art. 162.** Anëtarët dhe ndihmës anëtarët e këtij Këshilli të Shtetit emërohen prej Mbretit ndërmjet kandidatëve dyfish të zgjedhur prej Komisionit të Posaçëm, i përbërë prej Kryeministrit, Kryetarit të Parlamentit dhe të Ministrit të Drejtësisë. Nëpunësit e tjerë emërohen sipas ligjit.

**Art. 163.** Kryetari i Këshillit të Shtetit emërohet nga Mbreti, midis anëtarëve të këtij Këshilli. Gjithashtu Kryetari i këtij këshilli, drejtpërdrejt, mund të shkarkohet nga detyra e Kryesisë prej Mbretit.

**Art. 164.** Mënyra e ushtrimit të kompetencave të Këshillit të Shtetit bëhet sipas ligjit të posaçëm.

**Art. 165.** Kryetari, anëtarët dhe ndihmësanëtarët e Këshillit të Shtetit, për fajet gjatë detyrës ose në detyrë e sipër, akuzohen dhe dërgohen në Gjyqin e Lartë me vendimin e Parlamentit.

**Art. 166.** Anëtarët dhe ndihmësanëtarët e këtij Këshilli zgjidhen për shtatë vjet, dhe kjo kohë fillon që prej datës së dekretit; këta betohen përpara Mbretit para se të fillojnë detyrën. Imuniteti i këtyre brenda kësaj kohe është i siguruar, veç rasteve të parashikuara në ligjin e pensionit, dhe kur vendoset prej Parlamentit pushimi ose dërgimi i tyre në Gjyqin e Lartë.

**Art. 167.** Anëtarët dhe ndihmësanëtarët e Këshillit të Shtetit, përveç cilësive të kërkuara me ligj, duhet të jenë persona të pajisur me diplomë universiteti e të shquar në dije e zotësi.

**Art. 168.** Detyrat e Këshillit të Shtetit janë:

- a) të përgatitë kodet;
- b) të përgatitë e të shqyrtojë çdo projektligj e rregullore të referuar;
- c) të shqyrtojë dhe të japë mendimin e vet mbi konvencionet e konçensionet;
- ç) të përmbarojë detyrat e ngarkuara me ligjin e posaçëm dhe me ligjet e ndryshme të Shtetit.

Titulli V

*Forcat e Mbrojtjes Kombëtare.*

**Art. 169.** Forcat e armatosura të Shtetit, nën urdhërin absolut të Pushtetit Përmbarues, kanë për detyrë mbrojtjen e nderit, të pavarësisë e tërësisë tokësore të Atdheut, dhe të interesave të larta materiale e morale të Shtetit.

**Art. 170.** Forcat e Armatosura janë:

- a) Ushtria kombëtare (gjithë forcat tokësore, detare, ajrore.)
- b) Policia.

## **PJESA A**

### **Ushtria Kombëtare**

**Art. 171.** Shërbimi ushtarak është i detyrueshëm për të gjithë shtetasit shqiptarë, përveç përjashtimeve të përcaktuara me ligj.

**Art. 172.** Organizimi i pjesëve të ndryshme të ushtrisë rregullohet me ligj, por mënyra e aplikimit të tij dhe formimi i njësive bëhet me urdhrin Mbretëror.

**Art. 173.** Efektivat e forcave të armatosura caktohen çdo vit, në buxhetin e Shtetit.

**Art. 174.** Intendencat e Forcave të Armatosura drejtohen dhe organizohen prej Komandave të përgjithshme përkatëse. Komandat në fjalë, autorizohen të disponojnë buxhetet e tyre, por kurdoherë nën kontrollin efektiv të Ministrisë së Financave.

**Art. 175.** Gjykatat ushtarake në çështje penale veprojnë sipas ligjeve dhe procedurës së posaçme. Rregulloret që i përkasin disiplinës ushtarake dhe ndëshkimeve disiplinore në dekretohen (edictet) me urdhrin Mbretëror.

**Art. 176.** Të gjitha Forcat e Armatosura të Shtetit formojnë një trup dhe janë nën komandën e urdhrin absolut të Mbretit.

**Art. 177.** Mbreti, në kohë lufte mund t'ia ngarkojë një oficeri me gradë të lartë komandën efektive të operacioneve. Kur Mbreti merr përsipër vetë komandën e përgjithshme efektive, është drejtpërdrejt përgjegjës para Kombit për çka i përket zbatimit të operacioneve.

**Art. 178.** Mbreti urdhëron thirrjen nën armë të rekrutëve dhe në raste të caktuara me ligj ose në raste të jashtëzakonshme, të rezervistëve; vetëm Ai rregullon dhe urdhëron mënyrën e ndarjes së forcave ndër vende të ndryshme; forcat nuk mund të lëvizin pa urdhrin e Tij, të komunikuar me anë të Komandës së Mbrojtjes Kombëtare.

**Art. 179.** Mbreti, si Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, pa ndërmjetësi, i jep urdhra Komandës së Mbrojtjes Kombëtare.

**Art. 180.** Për veprime ilegale është përgjegjës para ligjit Komandanti i Mbrojtjes Kombëtare.

Komanda e Mbrojtjes Kombëtare përfaqësohet përpara Pushtetit Legjislativ me ndërmjetësinë e Kryeministrit.

**Art. 181.** Gjithë trupat ushtarakë absolutisht janë të detyruar t'u binden urdhrave të Mbretit. Ky detyrim përmendet në betimin që bëhet përpara Flamurit Kombëtar.

**Art. 182.** Emërimi i oficerëve nëpër trupa, që prej Komandantit të kompanisë e lart bëhet prej Mbretit. Këta oficerë përsërisin besnikërinë dhe bindjen e tyre kundrejt Mbretit, duke u betuar përpara Flamurit Kombëtar.

**Art. 183.** Grada ushtarake fitohet ose humbet sipas dispozitave të ligjeve në fuqi, si dhe me dekret Mbretëror.

Pensionet ushtarake rregullohen me ligj.

**Art. 184.** Komandanti i Mbrojtjes Kombëtare dhe Kryetari i Shtabit Madhor janë këshilltarë të natyrshëm të Mbretit në çështjet ushtarake, të cilat vendosen vetëm prej Mbretit.

Mbreti në raste të rëndësishme mund të formojë një Këshill Ushtarak.

**Art. 185.** Të huajt nuk mund të merren në shërbimin ushtarak, përveçse si organizatorë me kontratë, e cila nuk mund të lidhet për një kohë më të gjatë se pesë vjet.

**Art. 186.** Çdo faj i kryer (commis) në kohë paqeje prej civilëve, së bashku me ushtarakë, gjykohet prej gjykatave të zakonshme; ndërsa në kohë lufte, prej gjykatave ushtarake.

**Art. 187.** Asnjë forcë e armatosur e huaj nuk mund të vijë në tokën shqiptare dhe asnjë forcë e armatosur shqiptare nuk mund të dërgohet jashtë Shqipërisë, përveçse në rastet e vendosura prej Parlamentit.

**Art. 188.** Pjesëtarët aktivë të forcave të armatosura gëzojnë të gjitha të drejtat qytetare, përveç përjashtimeve të caktuara me ligj.

## **PJESA B**

### **Policia**

**Art. 189.** Organizimi dhe numri i Policisë caktohet me ligj të posaçëm.

**Art. 190.** Policia e Shtetit, në pikëpamjen ushtarake lidhet me Komandën Supreme, në mënyrën e caktuar me dispozitat relative të pjesës A, të këtij titulli; dhe në pikëpamje të detyrës është nën urdhrin e Ministrisë së P. të Brendshme; ajo vepron sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## **Titulli VI**

### **Të drejtat e qytetarëve**

**Art. 191.** Çdo Shqiptar lind dhe rron i lirë. Në Shqipëri as blihet as shitet njeri; çdo njeri i blerë ose skllav, porsa të shkelë tokën shqiptare është i lirë.

**Art. 192.** Liria është ndër të drejtat e natyrshme për çdo njeri dhe kufizohet me kufirin e lirisë të së tjerëve.

Ky kufi caktohet velëm me anë të ligjeve.

**Art. 193.** Liria personale është e garantuar. Askush nuk mund të ndiqet, të arrestohet, të burgoset veçse në rastet e parashikuara prej ligjit dhe në formën e caktuar prej tij.

**Art. 194.** Të gjithë shtetasit janë të barabartë para ligjit dhe pa përjashtim janë të detyruar të respektojnë ligjet.

**Art. 195.** Të gjithë Shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtat politike e civile, dhe pranohen në të gjitha nëpunësitë civile e ushtarake, përveç përjashtimeve të caktuara prej ligjit.

**Art 196.** Banesa është e padhunueshme. Asnjë hyrje me forcë në banesë nuk mund të bëhet, veç kur dhe si e urdhëron ligji.

**Art. 197.** Liria e fjalës dhe e shtypit është e garantuar. Çensura parandaluese nuk mund të vihet, përveç në kohë lufte, mobilizimi dhe në raste të jashtëzakonshme të tjera të parashikuara prej ligjit.

Kushtet mbi rregullimin e shtypit, konfiskimi i shtypshkrimeve dhe ndjekjet ligjore mbi gabimet e shtypit caktohen me ligj.

Vetëm shtetasit shqiptarë mund të nxjerrin gazeta në Shqipëri.

**Art. 198.** E drejta e pronësisë, për çfarëdolloj pasurie që të jetë, është e padhunueshme; pa të qenit e vërtetuar rregullisht nevoja e interesit botëror dhe pa mospagesën e vlerës së arsyeshme, sipas ligjit të posaçëm nuk mund të shpronësohet pasuria e askujt.

**Art. 199.** E drejta e formimit të shoqatave (associations) dhe e drejta e tubimit paqësisht dhe pa armë janë të garantuara në përputhje me ligjet.

Shoqatat kurrë nuk mund të përndahen për kundravajtje ligjore, veçse me vendim gjyqi.

Në mbledhjet publike mund të ndodhen organet e policisë.

Tubimet që organizohen përjashta në vende të hapura, mund të ndalohen në qoftë se prej grumbullimit lind rreziku i prishjes së qetësisë publike.

**Art. 200.** Shtetasit shqiptarë, brenda kufirit të ligjeve kanë të drejtë të formojnë shoqëri (societes); përdorimi i kësaj të drejte nuk i nën shtrohet asnjë masë parashikuese.

**Art. 201.** Fshehtësia e letrave dhe e korrespondencës telegrafike dhe telefonike është e padhunueshme, përveçse në rast lufte, mobilizimi, kryengritjeje, dhe në hetime mbi krime të rënda.

Ligji relativ cakton përgjegjësi mbi ata që çënojnë fshehtësinë e letrave dhe të korrespondencës telegrafike dhe telefonike

**Art. 202.** Udhëtimi nuk mund pengohet në asnjë mënyrë, përveç në raste të parashikuara me ligj.

**Art. 203.** Liria e mendimit dhe e ndërgjegjes është e garantuar. Shfaqja e mendimeve në mënyra të ndryshme, duhet të jetë në përputhje me ligjin.

**Art. 204.** Vetëm shtetasit shqiptarë pranohen si nëpunës të Shtetit; të huajt mund të merren në shërbim, vetëm si specialistë me kontratë, e cila nuk mund të lidhet për një kohë më të gjatë se pesë vjet.

**Art. 205.** Çdo mundim trupi (torturë) është krejt i ndaluar.

**Art. 206.** Arsimi fillor për të gjithë shtetasit shqiptarë është i detyruar dhe në shkollat e Shtetit jepet falas.

**Art. 207.** Në përputhje me ligjet dhe brenda parimeve të programit të pranuar prej Shtetit për shkollat e veta dhe kurdoherë nën kontrollin efektiv të Qeverisë, vetëm shtetasit shqiptarë mund të hapin shkolla të ndryshme private.

Të huajt, në përputhje me ligjet, mund të lejohen vetëm për shkolla teknike e bujqësore me programe teorike dhe praktike.

Gjithashtu mund të hapen shkolla fetare dhe prej komuniteteve fetare shqiptare shkolla fetare me lejen e Ministrisë kompetente e konform ligjeve; numri i nevojshëm i shkollave fetare të çdo komuniteti, po ashtu edhe numri i nxënësve të këtyre shkollave caktohen prej Ministrisë përkatëse me vendimin e Këshillit Ministror.

**Art. 208.** Konfiskimi është i ndaluar dhe s'mund të bëhet veçse sipas ligjit me vendim gjyqi.

**Art. 209.** Angaria është e ndaluar. Shteti në kohë lufte ka të drejtë të bëjë rekuizime dhe me një ligj të posaçëm të emetojë hua të brendshme dhe të detyrueshme.

**Art. 210.** Asnjë shtetas nuk mund të nxirret jashtë Shtetit.

Asnjë shtetas nuk mund të internohet brenda Shtetit dhe as detyrohet t'i caktohet një vendbanim i detyrueshëm, përveç rasteve të parashikuara me ligj.

**Art. 211.** Ekstradimi i shtetasve është krejt i ndaluar.

**Art. 212.** Secili ose shumë së bashku, gjithashtu edhe personat moralë kanë të drejtë t'u drejtohen me shkrim ose me gojë autoriteteve kompetente dhe Parlamentit për të drejtat private dhe botërore.

Kërkesave që bëhen për çështje private autoritetet janë të detyruar t'u përgjigjen me shkrim sa me shpejt.

**Art. 213.** Askush nuk mund të thirret, as të gjykohet prej një gjykate tjetër, veçse prej asaj që është kompetente me ligj.

## **Titulli VII**

### **Dispozita të ndryshme**

**Art. 214.** Një shtetas shqiptar nuk mund të jetë në të njëjtën kohë edhe shtetas i një Shteti të huaj.

Shtetësia shqiptare fitohet, mbahet (conserver) dhe humbet sipas dispozitave të caktuara në Kodin Civil.

**Art. 215.** Të gjithë të huajt, që ndodhen në Shqipëri gëzojnë mbrojtjen e akorduar personave dhe pasurive, përveç përjashtimeve të caktuara me ligj.

Të huajt, në asnjë rast, nuk kanë të drejtë pronësie në Shqipëri mbi tokat rurale me çdo titull qoftë; gjithashtu të huajt nuk kanë të drejtë pasurie të patundshme në vendet që janë afër kufijve të Shtetit ose në tokat bregdetare të cilat caktohen me Dekret Mbretëror dhe vendimin e Këshillit të Ministrave. Kjo dispozitë nuk çënon të drejtat e parafituara.

Të huajt kanë vetëm të drejtën e vlerës duke shitur tokat në fjalë dhe të drejtën e pronësisë vetëm mbi ato toka rurale që janë të nevojshme për ngritjen e fabrikave dhe për rregullimin e komunikacionit.

**Art. 216.** Asnjë organizim Shteti nuk mund të bëhet dhe të ndryshohet, veçse me ligj. Asnjë nëpunësi nuk mund të krijohet veçse me ligj.

Qarkshkrimet administrative, gjyqësore, ushtarake dhe të çdo dege tjetër, si edhe ndërrimet e qendrave të tyre, rregullohen vetëm me ligj.

**Art. 217.** Asnjë dënim nuk mund të jepet dhe të zbatohet, veçse në bazë të ligjit.

**Art. 218.** Ligjet nuk mund të kenë fuqi prapavepruese, përveç atyre që lehtësojnë dënimet penale.

**Art. 219.** Shteti njeh personat moralë të krijuar sipas ligjit.

**Art. 220.** Cilësitë, të drejtat, detyrat, rrogat, pensionet, shpërblimet dhe mënyra e emërimit dhe e çëmërimit, gradimit, çgradimit dhe marrja në gjyq për shkak detyre e nëpunësve, caktohen me ligj të posaçëm.

**Art. 221.** Nëpunës të disponueshëm mbahen në ushtri, dhe kjo në degët e ndryshme të administratës kur parashikohet në ligjin e buxhetit.

**Art. 222.** Toka është pronë e thjeshtë (mulq) dhe për të zbatohen dispozitat e Kodit Civil. Derisa të hyjë në fuqi Kodi Civil, mbi tokat, zbatohen dispozitat ligjore të deritanishme.

**Art. 223.** Ky Statut nuk mund të pezullohet as përgjithësisht as pjesërisht.

Asnjë ligj ose rregullore nuk mund të formulohet kundër shkronjave dhe thelbit të këtij Statuti.

## **Titulli VIII** **Rishikimi i Statutit**

**Art. 224.** Propozimet për interpretim autentik, modifikim, shtesë dhe rishikim (përgjithësisht ose pjesërisht) në Statut, nuk mund të bëhen veçse prej Mbretit ose prej Parlamentit.

Propozimet kësisoj, përveç rishikimit të përgjithshëm, duhet të përmbajnë qartë të gjitha pikat e Statutit për të cilat kërkohet interpretim, modifikim, shtesë ose rishikim pjesërisht.

Vetëm për artikujt 1, 2, 6, 50, 51, 52, 70, të këtij Statuti, nuk mund të propozohet dhe të pranohet rishikim.

**Art. 225.** Propozimet e përmendura në artikullin 224, kur bëhen prej Parlamentit, duhet të jenë të nënshkruara të paktën nga një e treta e atyre që e përbëjnë Dhomën.

**Art. 226.** Propozimet e përmendura në art. 224, në parim votohen me dy të tretat e votave të mbledhjes; por votimet e dyta bëhen me tre të katërtat e anëtarëve të përgjithshëm që e përbëjnë Parlamentin.

**Art. 227.** Kur përveç artikujve 1, 2, 6, 50, 51, 52, 70, bëhen propozime mbi nevojën e rishikimit të përgjithshëm të Statutit, ose mbi modifikimin e dispozitave të artikujve 8 e 53, dhe në qoftë se këto propozime pranohen në parim me tre të katërtat e votave të anëtarëve që e përbëjnë Dhomën, atëherë Parlamenti quhet vetvetiu i shpërndarë dhe zhvillohen zgjedhje të reja sipas artikullit 35 të këtij Statuti për një Asamble rishikimi, e cila përbëhet prej dyfishit numrit të anëtarëve të Parlamentit të shpërndarë. Asambleja e Rishikimit mblidhet dhjetë ditë pas mbarimit të zgjedhjeve dhe diskuton vetëm mbi çështjet e pranura në parim prej Parlamentit të shpërndarë. Me mbarimin e kësaj detyre, Asambleja e rishikimit shpërndahet menjëherë dhe organizohen zgjedhje për Parlamentin.

**Art. 228.** Interpretimet autentike, modifikimet, shtesat që votohen prej Parlamentit, sipas artikullit 226, hyjnë në fuqi pasi të miratohen (sanction) nga Mbreti. Në rast mosmiratimi, brenda 15 ditëve prej datës së paraqitjes, Mbreti ia kthen Parlamentit duke shënuar arësyet e mosmiratimit; Parlamenti rishtazi merr çështjen në diskutim dhe, në qoftë se insiston në vendimin e parë, quhet vetvetiu i shpërndarë. Vendimi i Parlamentit të ri është përfundimtar dhe pronulguohet prej Mbretit.

**Art. 229.** Vendimet e Asamblesë së rishikimit, janë të formës së prerë dhe shpallen prej Mbretit, brenda 15 ditëve që prej datës së paraqitjes.

## TITULLI IX

### Dispozita tranzitore

**Art. 230.** Asambleja Kushtetuese, me mbarimin e votimit përfundimtar të këtij Statuti, do të vijojë si Parlament, deri në mbarimin e periudhës katërvjeçare, e cila fillon që prej që prej datës 16 gusht 1928.

**Art. 231.** Në ligjet e rregulloret e Shtetit, kudo që përdoret fjala "Republikë" zëvendësohet me fjalën "Mbretëri", dhe kudo që përmendet fjala "Presidenti i Republikës" zëvendësohet me fjalën "Mbret".

## **Titulli X**

### **Dispozita të fundit**

**Art. 232.** Dispozitat e ligjeve që vijnë në kundërshtim me dispozitat e këtij Statuti, janë të pafuqishme.

**Art. 233.** Të gjithë dispozitat statuore të mëparshme shfuqizohen.

**Art 234.** Ky Statut hyn në fuqi që ditën e shpalljes.

## **FUND**

Vërtetohet njësia me origjinalin.

Kryetari i Asamblesë Kushtetuese Pandeli Evangjeli, d. v.